




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Or. 17/1 Prot

Dt. 17.01.22



Shkodër, më 17.01.2022

Nr. 13/1 prot.

Lënda: Mbi Vendimin nr. 73, datë 23.12.2021 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave funksionale të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin”, neni 8, shkronja “a”, Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave funksionale të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 41, neni 54, shkronja “k”, neni 55 pika 2, neni 64, shkronja “c” të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 33, të ligjit nr. 9963, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 23, datë 30.07.2018 “Per procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 73, datë 23.12.2021 “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Vau Dejës”.

Për sa më sipër, Prefekti ju autorizon të procedoni.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,


P R E F E K T I

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr. 73, datë 23.12.2021.

**“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PROGRAMIT
BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025 DHE BUXHETIT VJETOR 2023 TË BASHKISË
VAU DEJËS”**

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës 23.12.2021 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të neneve 54 shkronja “k” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 33 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e veteqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9936 date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”, udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Mbi procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, dhe relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës:


KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1. Miratimin e Kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem 2023-2024 dhe buxhetit vjetor 2023 të Bashkisë Vau Dejës, sipas lidhjes nr. 1, bashkangjitur këtij vendimi.
2. Efektet e këtij vendimi janë nga data 1 Janar deri në 31 Dhjetor të vitit 2022.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për marrjen e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

Lidhja nr.1

KALENDARI I PËRGATITJES SË PROJEKT PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2023-2025 DHE BUXHETIT VJETOR 2023



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ardjan Çelepija



KRYETAR

Mark BISHA



Miratuar me 22 vota

Vota Pro 22

Vota Kundër -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 31 . 12 . 2021 .